



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"**  
**REKTORATI**

Nr 344/1 prot

Elbasan, më 12.02.2022

**VENDIM**

Nr 04 datë 12.02.2022

**Për dhënie me qira ambientet e UE-së**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", VKM-së Nr.54, datë 05.02.2017 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore" i ndryshuar, bazuar në relacionin "Për dhënie me qira ambientet e UE-së", Bordi i Administrimit,

**VENDOSI:**

- 1- Të miratohet vazhdimi i dhënies me qira (në përfundim të kontratës së mëparshme) në një afat 1 (një) vjeçar i mjediseve, si më poshtë:
  - a) Mjedisi në mesin e Korpusit Kryesor, në ambientet e brendshme ngjitur me anfiteatrin (poshtë shkallëve të tij), me sipërfaqe 34.8 m<sup>2</sup>, i ndërtuar posaçërisht për shërbime ndaj studentëve, me aktivitet: Librari Universitare, shërbime fotokopje, kachelari;
  - b) Mjedisi në anën e jashtme të mesin të korpusit kryesor, ngjitur me të, nga jashtë portës nga ana e anfiteatrit, jashtë mesin, në anën ku janë zyrat e administratës me sipërfaqe ndërtese 123.75 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe funksionale 41 m<sup>2</sup>, për ushtrimin e aktivitetit: tregtim ushqimi të shpejtë, kafe, kakao, çaj dhe pije freskuese në shërbim të personelit të universitetit dhe studentëve;
- 2- Ngarkohet Administratori i Universitetit me zbatimin e këtij vendimi.  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I BORDIT**  
**ARDIAN DURMISHI**

